



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE
"Ambienti" SH.A. FERIZAJ
Nr. pro. 353 /24
Data: 31.05.2024

RAPORTI VJETOR I NDËRMARRJËS PUBLIKE LOKALE "AMBIENTI" Sh.A. FERIZAJ PËR VITIN 2023

Ferizaj – Maj 2024

PËRMBAJTJA

H Y R J E	3
Korniza ligjore	4
Organizimi dhe struktura organizative e ndërmarrjes.....	4
Sektorët e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj janë:.....	5
Zyret e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj janë:	5
Planifikimi i Burimeve njerëzore (personeli)	5
Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore	6
Fushëveprimtaria.....	6
Misioni	6
Vizioni.....	7
Objektivat.....	8
Planifikimi operativ dhe planifikimi financiar.....	8
Raporti operativ për vitin 2023	9
Performanca financiare e ndërmarrjes	14
Trendet e të hyrave gjatë vitit 2021, 2022, 2023	14
NDRYSHIMI I TË HYRAVE DHE FITIMI PËR VITE	14
Shpenzimet e pagave për tre vite	15
Ndryshimi i kapitalit për vitet 2021-2023.....	16
PROJEKTET DHE INVESTIMET PËR VITIN 2024	16
Grafikoni i investimeve në vitin 2024	17
ORGANOGRAMI I NDËRMARRJES	18
Takimet e Bordit të Drejtorëve të NPL "Ambienti" Sh.A – Ferizaj gjatë vitit 2023	19
Takimet e Komisionit të Auditimit të Brendshëm të NPL "Ambienti" Sh.A Ferizaj.....	19
KNAQSHMËRIA E KONSUMATORËVE	20
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN 2023...	29
MIRATIMI I RAPORTIT VJETOR 2023.....	43

Lista e Figurave

Figure 1. Foto në QMF	11
Figure 2. Foto rrethrrrotullimi Uran Tinova.....	11
Figure 3. Foto Maja e Lirisë në Gremc.....	12
Figure 4. Pastrimi i Lapidarit.....	12
Figure 5. Pastrimi dhe mirëmbajtja e vearrezave të dëshmorevë	13
Figure 6. Pastrimi dhe mirëmbajtja e vearrezave të dëshmorevë	13
Figure 7. Krasitja e drunjëve dekorativ në Bulevardin Dëshmorët e Kombit	13
Figure 8 Investimet në 5 mujorin e parë të vitit 2024.....	17

Lista e Tabelave

Table 1. Numri i të punësuarëve.....	5
Table 2. Punët e kryera	10

HYRJE

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, është ndërmarrje e cila kryen shërbime të ndryshme, në shërbim të interesit të përgjithshëm qytetarë, si në qytet ashtu edhe nëpër fshatra nëpër gjithë territorin e Komunës së Ferizajt. Ndërmarrja kryesisht menaxhon me parkingjet publike në Komunën e Ferizajt, menaxhimin e tregjeve (tregun e gjelbërt, tregun e gjelbërt dhe të kafshëve në Dardani si dhe tregun e kafshëve në Mohoc), mirëmbajtjen e oborreve të zyrave të gjendjes civile, qendrat e mjekësisë familjare (QKMF), ambulancat, parqet, kopshtet e fëmijëve, bibliotekat, fushat sportive, hapësirat e gjelbërta publike, oborret e banesave të vjetra kolektive, prerja e drunjëve, mirëmbajtja e trotuarëve dhe punë të tjera të cilat mund të kontraktohen nga Komuna e Ferizajt. Të hyrat nga parkingjet publike dhe tregjeve janë të hyra vetanake, ndërsa mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese publike janë të hyra nga Komuna e Ferizajt, gjegjësisht nga Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, varësisht prej punëve sa kryen ndërmarrja në teren në bazë të marrëveshjes në mes Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A Ferizaj dhe Komunës së Ferizajt.

Kuvendi i Komunës së Ferizajt me datën 27.05.2014 ka marr Vendim me Nr.86, me të cilin vendim u bë themelimi i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A Ferizaj, ku më pas me datën 23.03.2016 Kuvendi i Republikës së Kosovës aprovon këtë vendim dhe nxjerr Vendim me numër protokolli 09/81 për Themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj.

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, është Shoqëri Aksionare, në të cilën Komuna e Ferizajt është në pronësi 100% të aksioneve në N.P.L "Ambienti" Sh.A. Ferizaj. Sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike (Ligji nr.03/L-087) i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin (Ligji nr.04/L-111) dhe (Ligjin nr.03/L-009), Ligjit Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare, Npl "Ambienti" Sh.A. Ferizaj është Ndërmarrje Publike Lokale e organizuar si Shoqëri Aksionare, e cila sipas ligjit i përgjigjet dhe e i raporton Kuvendit të Komunës të Ferizajt dhe Komunës së Ferizajt, përmes Komisionit Komunal të Aksionarëve i Npl "Ambienti" Sh.A. Ferizaj.

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj është shoqëri aksionare, e regjistruar bazuar në projektin për inkuorimin e sektorit të mirëmbajtjes dhe kujdesit të mjedisit në Ferizaj, është e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Ndërmarrjeve Biznesore dhe Emrave Tregëtar në Kosovë bazuar në Ligjin 05/L-123 për Shoqëritë Tregëtare dhe posedon Nr. unik identifikues 811053850 si dhe certifikatë regjistrimi për T.V.Sh. Nr. 330331215. Biznesi është i regjistruar si ndërmarrje shërbyese dhe aktivitet kryesor ka aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor. Ndërmarrja është regjistruar edhe për kryerjen e aktivitetëve sekondare dhe aktivitetëve tjera.

Në këtë raport përshkruhet afarizmi vjetor i bazuar edhe në strategjinë e ndërmarrjes, me qëllim të ofrimit të të gjitha informatave të nevojshme, të cilat janë të rëndësishme për marrjen e vendimeve në ndërmarrje.

Rëndësia e këtij raporti është se i njëjti do të shërbej për Menaxhmentin e Ndërmarrjes Npl "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, si dokument për zhvillimin dhe vendosjen e prioriteteve të investimeve në të ardhmen, është shumë i rëndësishëm për të arritur sukses, i cili na ndihmon të përcaktohem në qëllimet, strategjitë dhe hapat e mëtejshëm, me qëllim që të kemi suksese dhe rezultate.

Korniza ligjore

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj veprimtarinë operative dhe financiare do t'a organizojë dhe do ti përmbushë detyrimet, duke marrë për bazë zbatimin e dispozitave pozitive ligjore dhe akteve nënligjore:

1. Ligji Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, dhe plotësim ndryshimet e ligjit;
2. Ligji Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
1. Ligji Nr. 03/L – 025 për Mbrojtjen e Mjedisit;
2. Ligji Nr. 03/L- 048 për Menaxhimin e Financave Publike;
3. Ligji Nr. 04/L-116 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi;
4. Ligji Nr. 03/L-212 i Punës;
5. Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës;
6. Ligji Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike;
7. Statuti i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A Ferizaj;
8. Rregullorja 02/2013 për Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale 02/2013;
9. Vendimi 01.Nr.86 i datës 27.05.2014 i Kuvendit të Komunës të Ferizajt;
10. Vendimi Nr. 09/81 i datës 23.03.2016 i Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Organizimi dhe struktura organizative e ndërmarrjes

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj menaxhohet nga Kryeshefi Ekzekutiv, mbikqyret nga Bordi i Drejtorëve. Sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike dhe organogramit të ndërmarrjes, menaxhmenti i lartë i ndërmarrjes përbëhet nga pozitat si në vijim: Kryeshefi Ekzekutiv (KE), Sekretari i ndërmarrjes, Zyrtari i Lartë Financiar dhe Zyrtari për Auditim të Brendshëm.

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj organizohet në sektorë dhe zyre, të cilët për punën e tyre i përgjigjen drejtpërdrejtë Kryeshefit Ekzekutiv të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj.

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, përbëhet prej 5 sektorëve dhe 5 zyreve, dhe pjesa tjetër e mbetur inkorporohet në këto sektorë apo zyre.

Sektorët e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj janë:

1. Sektori i Administratës;
2. Sektori i Financave dhe Kontabilitet;
3. Sektori i Operativës;
4. Sektori Inkasimit, dhe
5. Sektori i Kontrollës.

Zyret e Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj janë:

1. Zyra e Prokurimit;
2. Zyra Ligjore;
3. Zyra e Burimeve Njerëzore;
4. Zyra për Marketing, dhe
5. Zyra për Klientë.

Planifikimi i Burimeve njerëzore (personeli)

Numri aktual i të punësuarve në Ndërmarrjen Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, aktualisht është si në vijim:

Nr. Rendor	EMËRTIMI	NUMRI
1.	Komisioni Komunal i Aksionarëve	3
2.	Bordi i Drejtorëve	4
3.	Administrata	20
4.	Kontrollë	14
5.	Inkasant	32
6.	Hapësira të Gjelbërta	12
7.	Punonjës sezonal (hapësira të gjelbërta)	5
8.	TOTALI	90

Table 1. Numri i të punësuarëve

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, varësisht prej vëllimit të punëve dhe sipas nevojës e rrit edhe numrin e të punësuarve në ndërmarrje. Gjithashtu ndërmarrja sipas nevojës dhe vëllimit të punëve angazhon edhe punonjës sezonal, në vitin 2023 kanë qenë të angazhuar 5 punonjës sezonal.

Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore

Në bazë të kërkesave të sektorëve, do të bëhet një analizë e nevojave për trajnime dhe mbi këtë analizë do të hartohet plani i trajnimeve. Trajnimet duhet të jenë të fokusuara konform nevojave të stafit për njohuri të cilat do të përdoren gjatë kryerjes së detyrave në ndërmarrje duke mbuluar trajnimet e demosdoshme për ngritje profesionale, konform dispozitave ligjore pozitive.

Fushëveprimtaria

1. Menaxhimin e të gjitha vendparkingjeve të cilat janë në pronësi të Komunës së Ferizajt;
2. Menaxhon hapësirat e gjelbëruara (Parkun "Liria", parkun në qendër të qytetit, parkun e pishave në Rahovicë dhe parqet e tjera të qytetit), si dhe parqet e rregulluara në territorin e Komunës së Ferizajt;
3. Mirëmbajtjen e vendparkingjeve;
4. Dhënien e lejeve dhe hyrjen e automjeteve në vende të siguruara për parking;
5. Kujdeset dhe mirëmban sheshin e qytetit dhe sheshet të tjera në qytet;
6. Kujdeset për mirëmbajtjen e përmendoreve brenda dhe jashtë qytetit;
7. Mirëmban varrezat e dëshmorëve;
8. Mbjelljen e luleve dhe drunjëve dekorues;
9. Mirëmbajtjen dhe krasitjen e drunjëve në qytet dhe fshat;
10. Mirëmbajtja e objekteve publike banesore kolektive;
11. Mirëmbajtja higjenike e objekteve publike;
12. Menaxhimin e tregjeve (tregun e gjelbërt, tregun e kafshëve, tregun në Dardan

Misioni

Misioni i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj, është t'i mbuloj dhe të ju shërbej me shërbime të cilat bien në domenin e ndërmarrjes të gjithë qytetarët e Komunës së

Ferizajt, pa dallim race, religjioni apo kombësie, të shërbejë dhe të kontribuojë në mirëqenien e qytetarëve dhe komunitetit të tyre, kjo mund të përfshijë organizimin e fushatave për ruajtjen e mjedisit, përmirësimin e infrastrukturës publike dhe promovimin e vlerave të rëndësishme për shoqërinë në aspektin e të gjelbërtës (Green Agenda).

NPL "Ambienti" Sh.A. Ferizaj mision i saj është që të kujdeset për parqet dhe hapësirat e gjelbërta në fshat dhe qytet, duke siguruar mjedis të pastër dhe tërheqës për të gjithë qytetarët dhe vizitorët, kjo përfshinë mirëmbajtjen dhe ruajtjen e ambientit të përbashkët, me qëllim për të krijuar një ambient të qetë dhe të relaksuar për të gjithë përdoruesit.

Mision tjetër i ndërmarrjes është që të sigurohemi që ndërmarrja në aspektin financiar dhe operativ të jetë e vetë-qëndrueshme dhe në aspektin kohor të jetë afatgjatë, që të mund të sigurojë menaxhimin me standart të lartë të hapësirave publike dhe parkingjeve publike në pajtim me standardet ndërkombëtare, ku duke përmbushur këtë mision do të jetë e mundur sigurimi i vetëqëndrueshmërisë së ndërmarrjes në aspektin afatgjatë.

Qasja në afarizimin e ndërmarrjes do të jetë transparenca dhe llogaridhënia e bazuar në dispozitat pozitive ligjore. Transparenca dhe llogaridhënia do të bëhet në bashkëpunim me palët e interesit:

1. Qytetarët;
2. Fokus grupet;
3. Palët e interesit;
4. Organizatat jo qeveritare
5. Ministrinë e Linjës;
6. Komisioni Komunal i Aksionarëve i NPL "Ambienti" Sh.A. Ferizaj i Komunës së Ferizaj,
7. Bordin e Drejtorëve NPL "Ambienti" Sh.A. Ferizaj

Vizioni

Vizioni i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj është të ndihmojë në krijimin e një qytetit (mjedis) të qëndrueshëm të pastër, të zhvilluar dhe të përmirësuar për të gjithë qytetarët. Ky vizion përfshinë zhvillimin e infrastrukturës, mbrojtjen e mjedisit, promovimin e mirëqenies së përgjithshme në komunitet, ruajtjen dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta publike, krijimin e hapësirave të gjelbërta publike, promovimin e energjisë të pastër dhe përmirësimin e shërbimeve në vazhdimësi si në menaxhimin e hapësirave të gjelbërta publike, ashtu edhe menaxhimin e parkingjeve publike dhe tregjeve.

Vizion tjetër është ti zgjeroj shërbimet, të sigurojë një kualitet të shërbimeve në pajtim me normat dhe standardet e BE-së. Ruajtja dhe mirëmbajtja e aseteve të ndërmarrjes, si dhe rritja e

investimeve kapitale, për të garantuar ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj klientëve ekzistues dhe atyre potencial në të ardhmen. Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe rritja e qëndrueshmërisë financiare është synimi kryesor i ndërmarrjes.

Përmes aktiviteteve të rëndomta operative dhe financiare në të ardhmën do të krijohen kushte të favorshme, për rritjen e nivelit të investimeve nga burimet vetanake dhe nga investitorët tjerë. Përafrimi i përmbushjes së një vizioni të tillë, do të krijojë parakushte më të mira për bashkëfinancim dhe investime nga institucionet tjera financiare.

Objektivat

Objektivat kryesore të Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A. Ferizaj janë:

1. Përmirësimi i standardeve të shërbimeve, me fokus kryesor në përmirësimin e qëndrueshmërisë, sigurisë dhe cilësisë së shërbimeve;
2. Rritja e shkallës së ndërgjegjësimit në lidhje me vullnetin për të përmirësuar shërbimet, nëpërmjet zbatimit të funksionit të shërbimit për qytetarët më me efektivitet dhe cilësi;
3. Përmirësimi i performancës dhe arritja e qëndrueshmërisë financiare gjatë operimit të saj;
4. Zgjerimi i veprimtarisë e cila do të sigurojë rritjen e të hyrave gjatë viteve të ardhshme;
5. Ofrimi i shërbimeve më të mira për qytetarët;
6. Mbrojtja e mjedisit;
7. Qëndrueshmëria financiare;
8. Zvogëlimi i shpenzimeve operative;
9. Rritja e shkallës së faturimit dhe inkasimit;
10. Zgjerimi i shërbimeve në tërë territorin e Komunës së Ferizajt;
11. Thithja e fondeve dhe donacioneve nga organizatat e huaja dhe ato vendore;
12. Menaxhimi e oborreve të banesave publike kolektive për vendparkingje; dhe
13. Mirëmbajtja higjienike e hapësirave të brendshme dhe të jashtme të banesave publike kolektive.

Planifikimi operativ dhe planifikimi financiar

Ky seksion paraqet një analizë të ofrimit, të shërbimeve, të menaxhimit të hapësirave në Komunën e Ferizajt. Për parashikimet e performancës financiare janë përdorur si bazë tarifat ekzistuese, për të analizuar qëndrueshmërinë e menaxhimit të ndërmarrjes. Është vendosur që

çmimet për shërbimet e menaxhimit të hapësirave në komunë, të cilat do të ofrohen të jenë çmime të pranueshme të tregut.

~~Kostoja e ofrimit të shërbimeve për menaxhimin e hapësirave publike përbëhet nga kostot operative dhe kostot e çdo investimi potencial që kërkohet për ofrimin e një shërbimi të tillë. Pasi që ndërmarrja publike do t'i ofrojë shërbimet, nuk është supozuar ndonjë marzhë profiti. Megjithatë, të hyrat e gjeneruara duhet t'i mbulojnë kostot operative. Ky raport synon të ofrojë udhëheqje për nivelin e tarifave të nevojshme që duhet të arkëtohen në mënyrë që të mbulojnë kostot e ofrimit të shërbimeve.~~

Raporti operativ për vitin 2023

Gjatë vitit 2023 NPL "Ambienti" Sh.A - Ferizaj ka pasur një Marrëveshje për mirëmbajtjen e hapësirave publike në fshatra dhe oborret e institucioneve publike me Komunën e Ferizajt, marrëveshja përfshinë mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbërta, mbjelljen, krasitjen dhe prerjen e drunjëve dekorativ, pastrimi dhe mirëmbajtjen e varrezave dhe lapidarëve të dëshmorëve, parqeve publike, mirëmbajtja e fushave sportive në tërë territorin e Ferizajt, zyreve të gjendjes civile, qendrat e mjekësisë familjare, kopshtet publike të fëmijëve, hapësirat e gjelbërta të bibliotekave, mirëmbajtja e hapësirave të oborreve të ndërtesave publike kolektive.

NPL "Ambienti" Sh.A Ferizaj gjatë vitit 2023, ka kryer shërbime shtesë pa pagesë si: mirëmbajtja e hekurudhës, mirëmbajtja dhe kositja e Varrezave të Dëshmorëve, kemi ndihmuar shumë shkolla në mirëmbajtjen e parqeve të tyre (shkolla "Muharrem Shemsedini", "Astrit Bytyqi", "Vezir Jashari", "Afrim Abazi", Gjinnazi "Kuvendi i Arbërit" dhe "Shaban Hashani", Shkolla "Zenel Hajdini" et), parqeve të ndryshme tek Gjykata Themelore në Ferizaj, Prokuroria Themelore në Ferizaj, Stacioni Policor në Ferizaj, dhe shumë aktivitete në dobi të përgjithshme, në hapësirat e përbashkëta publike, dhe shumë punë të tjera të cilat janë kërkuar nga Komuna e Ferizajt.

Gjatë Vitit 2023 janë mbjellur dhe punuar hapësirat e gjelbërta si vijon:

Nr. Rendor	EMËRTIMI - PËRSIHKRIMI	M²
1.	Zyrët e gjendjes civile në fshatra (kositja)	15365
2.	Zyrët e gjendjes civile në fshatra (pastrimi)	23112
3.	Qendrat e mjekësisë familjare (kositja)	18220
5.	Qendrat e mjekësisë familjare (pastrimi)	25400
6.	Hapësirat gjelbëruese publike (kositja)	71810
7.	Hapësirat gjelbëruese publike (pastrimi)	21694
8.	Kopshtet publike të fëmijëve	12340
9.	Bibliotekat publike	8991
10.	Fushat sportive	11065
11.	Hapësirat të oborreve të ndërtesave të vjetra kolektive (kositja)	9800
12.	Hapësirat të oborreve të ndërtesave të vjetra kolektive (pastrimi)	13210
13.	Prerja dhe krasitja e drunjëve	65 copë
14.	Mirëmbajtja dhe pastrimi i hapësirave rreth lapidarëve të dëshmorëve	21320
15.	Vendosja e flamujve tek lapidarët e dëshmorëve	552 copë
16.	Larja e lapidarëve të dëshmorëve	56 herë
17.	Mirëmbajtja e shportave të mbeturinave	62 copë
18.	Mbjellja e drunjëve dekorativ	65 copë

Table 2. Punët e kryera

Në vazhdim mund të gjeni disa fotografi nga aktiviteti i përditshëm i mirëmbajtjes së hapësirave të gjelbërta publike.



Figure 1. Foto në QMF



Figure 2. Foto rrethrotullimi Uran Tinova



Figure 3. Foto Maja e Lirisë në Greme



Figure 4. Pastrimi i Lapidarit



Figure 5. Pastrimi dhe mirëmbajtja e vearezave të dëshmorevë



Figure 6. Pastrimi dhe mirëmbajtja e vearezave të dëshmorevë


Performanca financiare e ndërmarrjes

Marr për bazë nga vitet 2021, 2022, 2023, NPL "Ambienti" Sh.A Ferizaj ka pasur një ecuri kënaqshme të rritjes përkundër që pandemia kishte pasur një impakt të uljes së të hyrave për shkak të gjendjes së pandemisë dhe vendimeve të autoriteteve shtetërore në kufizime.

Vitin 2021 ndërmarrja kishte mbyllur vitin fiskal me një humbje të konsiderueshme prej 32,628.00 Euro. Viti 2022 ka qenë një vit ku ndërmarrja filloj të merr vetën dhe përkundër pasojave që pandemia kishte shfaqur prap se prap mbyllim vitin fiskal me një fitim prej 6,802.00 Euro.


Vetëm në vitin e fundit në 2023 mund të themi se ishte një vitë i suksesshëm pasi që të hyrat janë rritur 541,477.00 Euro, nëse e krahasojmë të hyrat e vitit 2021 me vitin 2023, atëherë shihet qartë se NPL "Ambienti" Sh.A Ferizaj, kishte një vlerë 233,284.00 Euro më shumë dhe shprehur në përqindje 43% rritje e të hyrave. Duke e par këtë trend dhe marrjen e disa masave nga menaxhmenti besojmë se edhe vitet pasuese do të jenë të sukseshme dhe me një përmbushje të qellimeve të aksionarit.

Trendet e të hyrave gjatë vitit 2021, 2022, 2023



(32,628.00) 6,802.00


Raporti i të hyrave dhe fitimi për Vite.



Shpenzimet e pagave për tre vite


Viti	2021	2022	2023
Sh.Pagat	€ 316,000.00	€ 340,780.00	€ 399,266.00

SH.PAGAT



Ndryshimi i kapitalit për vitet 2021-2023

Viti	2021	2022	2023
Kapitali	€ 47,555.00	€ 54,358.00	€ 131,912.00



PROJEKTET DHE INVESTIMET PËR VITIN 2024

Duke pasur për bazë punët dhe përgjegjësitë që NPL "Ambienti" që ka me Statut dhe ka paraparë në bazë të Planit të Biznesit, ndërmarrja ka prokuruar dhe është pajisur me mjete të punës shumë të nevojshme për kryerjen e punëve në terren, nga muaji Janar 2024 deri muajin Prill 2024 janë bërë këto investime të rëndësishme për funksionimin dhe arritjen e rezultateve sipas parashikimeve në bazë të planeve dhe dokumenteve të hartuara, për arritjen e caqeve të parapara, dhe njëjtën kohë në furnizime me makineri të cilat janë ekologjike, duke dhënë shembull për mbrojtjen dhe kujdesin për mjedisin.

Lista e investimeve në 5 mujorin e parë të vitit 2024 janë këto:

1. Blerja e një mjeti transportues (kamionet me kipper), prodhim i vitit 2008;
2. Uniforma (veshëmbathje për puntorët e terenti);

3. Paisje, makineri për sektorin e operativës (prerje bari, motorrë sharra, trimer, traktor për prerjen e barit, fryrëse, etj);
4. Thithëse elektrike për pastrimin e rrugëve (EKO shpenzime);
5. Ngritja e pagave për puntorët duke pas parasysh inflacionin etj.

Grafikoni i investimeve në vitin 2024





Figure 8 Investimet në 5 mujorin e parë të vitit 2024

ORGANOGRAMI I NDËRMARRJES



Takimet e Bordit të Drejtorëve të NPL "Ambienti" Sh.A – Ferizaj gjatë vitit 2023

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2023 kishte dymbëdhjetë (12) mbledhje të rregullta dhe një (1) mbledhje të jashtëzakonshme.

Këto takime janë mbajtur si më poshtë :

1. Mbledhje e rregulltë e bordit të drejtorëve, me datën 27.01.2023;
2. Mbledhje e rregulltë e bordit të drejtorëve, me datën 28.02.2023;
3. Mbledhje e rregulltë e bordit të drejtorëve, me datën 23.03.2023;
4. Mbledhje e rregulltë e bordit të drejtorëve, me datën 28.04.2023;
5. Mbledhje e rregulltë e bordit të drejtorëve, me datën 21.05.2023;
6. Mbledhje e rregulltë e bordit të drejtorëve, me datën 15.06.2023;
7. Mbledhje e jashtëzakonshme e bordit të drejtorëve, me datën 22.06.2023;
8. Mbledhje e rregulltë e bordit të drejtorëve, me datën 31.07.2023;
9. Mbledhje e rregulltë e bordit të drejtorëve, me datën 31.08.2023;
10. Mbledhje e rregulltë e bordit të drejtorëve, me datën 29.09.2023;
11. Mbledhje e rregulltë e bordit të drejtorëve, me datën 31.10.2023;
12. Mbledhje e rregulltë e bordit të drejtorëve, me datën 30.11.2023;
13. Mbledhje e rregulltë e bordit të drejtorëve, me datën 29.12.2023.

Takimet e Komisionit të Auditimit të Brendshëm të NPL "Ambienti" Sh.A Ferizaj

Komisioni i Auditimit të Brendshëm gjatë vitit 2023 kishte tri (3) mbledhje. Këto takime janë mbajtur:

1. Mbledhje e komisionit të auditimit të brendshëm, me datën 15.05.2023;
2. Mbledhje e komisionit të auditimit të brendshëm, me datën 15.08.2023;
3. Mbledhje e komisionit të auditimit të brendshëm, me datën 22.12.2023.

KNAQSHMËRIA E KONSUMATORËVE

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve i NPL "Ambienti" Sh.A Ferizaj, ka për obligim një herë në vit të masin kënaqësinë e konsumatorëve në bazë të procedurave përkatëse përmes organizatave kredibile të pavarura. Ky raport i dorëzohet Komisionit Komunal të Aksionarëve NPL "Ambienti" Sh.A Ferizaj, Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Bazuar në këtë më poshtë gjeni raportin e matjes së kënaqshmërisë së konsumatorëve.



AVONET
Rrjeti i Organizatave Joqeveritare
Network of Non-Governmental Organizations

Adresa: Rr."Ramadan Rexhepi" ish objekti i QAP, 70 000 Ferizaj, Kosovë
e-mail: avonet.rks@gmail.com
Cel: +383 44 800 114&+383 44 800 343

RAPORT I MATJES SË KNAQSHMËRISË SË KONSUMATORËVE

Kompania: NPL Ambienti Sh.A
Data e Matjes: 25.03.2024, Ferizaj

I. Përmbledhje

Rrjeti i OJQ-ve AVONET ka kryer një matje të kënaqshmërisë së konsumatorëve për shërbimet e ofruara nga NPL Ambienti Sh.A, e cila ka seli në Ferizaj. Ky raport synon të analizojë performancën dhe kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet dhe menaxhimin e hapësirave publike dhe parkingjeve publike të ofruara nga ky subjekt.

II. Detajet e Matjes

AVONET ka identifikuar se NPL Ambienti Sh.A ka një potencial të lartë për të rritur efikasitetin dhe për të përmirësuar qasjen ndaj shërbimeve të saj. Përmes një vlerësimi të opinionit publik dhe një pyetësi të strukturuar, janë marrë të dhëna mbi kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet e ofruara.

Objektivja e Matjes: Matja është zhvilluar përmes një pyetësi të realizuar gjatë pesë ditëve me radhë dhe me 100 korrespondentë. Pyetësi përbante nëntë (9) pyetje, të cilat u prezantuan në një format bashkëbisedimi dhe përgjigjet ishin anonime për çdo respondent.

Pjesëmarrja: Zhvillimi i pyetësit është bërë në mënyrë proporcionale sipas moshës, gjinisë dhe vendit prej nga vijnë respondentët. Procesi u realizua nga pesë (5) persona, duke investuar gjashtë (6) orë në ditë gjatë gjashtë ditëve të matjes.

Gjetjet e Matjes: Rezultatet e pyetësorit tregojnë se NPL Ambienti Sh.A gëzon një nivel të lartë besueshmërie dhe integriteti menaxherial tek qytetarët e Komunës së Ferizajt. Kënaqësia e qytetarëve lidhur me shërbimet e ofruara është e lartë dhe në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tyre.

Sipas pyetjes së parë: Sa jeni të kënaqur me ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së hapësirave publike nga NPL "Ambienti" nga 100 respondentë del që të jetë: 80% shumë i/e kënaqur, 15 % I/E kënaqur dhe 05% I/E pakënaqur.

Pyetja e dytë: Sa jeni të kënaqur me hapësirat e parkingjeve tek "Bashkim i Qytetit" dhe skaj rrugëve nga 100 korrespondent kanë dhënë përgjigje se: 75% shumë i/e kënaqur, 18 % I/E kënaqur dhe 07% I/E pakënaqur.

Përgjigjet në pyetjen e tretë janë dhënë: Sa jeni të kënaqur me mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese në QKMF-së, QMF-ve, Zyreve të Gjendjeve Civile, Kopshteve e Fëmijëve, Bibliotekat Fushat Sportive? nga 100 korrespondent kanë dhënë përgjigje se: 74% shumë i/e kënaqur, 16% I/E kënaqur dhe 10% I/E pakënaqur.

Në pyetjen e katër: Sa jeni të kënaqur me shërbimet e NPL "Ambienti" sh.a nga 100 korrespondent kanë dhënë përgjigje se: 76 % shumë i/e kënaqur, 18 % I/E kënaqur dhe 06% I/E pakënaqur.

Nga pyetja e pestë: Sa janë profesional punëtorët e NPL "Ambienti" sh. nga 100 korrespondent kanë dhënë përgjigje se: 74 % shumë i/e kënaqur, 20 % I/E kënaqur dhe 06% I/E pakënaqur.

Pyetja e gjashtë: Sa jeni të kënaqur me përkujdesin e kompanies NPL Ambienti SH.A dhe sjelljet e punëtorëve të saj nga 100 korrespondent kanë dhënë përgjigje se: 74 % shumë i/e kënaqur, 22 % I/E kënaqur dhe 04% I/E pakënaqur.

Në pyetjen e shtatë janë këto përgjigje: Sa jeni të kënaqur me mirëmbajtjen varrezave të Dëshmorëve, lapidareve në Ferizaj nga 100 korrespondent kanë dhënë përgjigje se: 82 % shumë i/e kënaqur, 13 % I/E kënaqur dhe 05% I/E pakënaqur.

Pyetja e tetë janë dhënë këto rezultatet: A jeni të kënaqur me përkushtimin dhe rendin e parkingjeve në zonën urbane nga 100 korrespondent kanë dhënë përgjigje se: 69 % shumë i/e kënaqur, 33 % I/E kënaqur dhe 08 % I/E pakënaqur.

Pyetja e nëntë janë dhënë përgjigje: A mendoni se duhet të menaxhohen objektet banesore nga NPL "AMBIENTI" sh.a dhe nga përgjigjia e qytetarëve del se janë për " PO - 74%, JO - 20 % dhe NUK DI - 06% "

III. Rekomandimet

Bazuar në matjen e kënaqshmërisë së konsumatorëve, rekomandimet për NPL Ambienti janë:

- ❖ Të merren në menaxhim mirëmbajtja higjienike të objekteve kolektive banesore.
- ❖ Rritja e kapaciteteve teknike për mirëmbajtjen e hapësirave publike.
- ❖ Të merren në menaxhiparkingjedhe mirëmbajtja rrugëve të lagjeve të qytetit.

IV. Konkluzion

Kjo matje tregon një nivel të lartë të kënaqshmërisë së konsumatorëve me shërbimet e ofruara nga NPL Ambienti Sh.A. Rekomandimet e dhëna nga qytetarët ofrojnë një udhërrëfyes për përmirësimin dhe përparimin e kompanisë në të ardhmen, duke reflektuar besimin dhe ndikimin e ndërmarrjes në jetën urbane të komunitetit të Ferizajt.

V. Përfundim i Shtuar

Bazuar në përgjigjet e anketimeve, rezulton se 75.33% e qytetarëve janë shumë të kënaqur me shërbimet e ofruara nga NPL Ambienti Sh.A, 18.33% janë të kënaqur dhe 6.34% janë jo të kënaqur.

Kenan Gashi,
Drejtor Ekzekutiv






RAPORT I PËRFORMANCËS

Në respektimin e ligjit për ndërmarrjet Publike, NPL Ambienti ka kontraktuar OJQ AVONET për të matur performancën e NPL Ambientit dhe prej mosrave të marrura kanë rezultuar rezultatet si në vijim:

1. Sa jeni të kënaqur me ofrimin e shërbimit të mirëmbajtjes së hapësirave publike nga NPL "Ambienti"

Respodent 100


Shumë i/e kënaqur 80% I/E I kënaqur 15% E/I Pa kënaqur 5%



2. Sa jeni të kënaqur me hapësirat e parkingjeve "Bashkim i Qytetit" dhe skaj rrugëve

Respodent 100


Shumë i/e kënaqur 75% I/E I kënaqur 18% E/I Pa kënaqur 7%



3. Sa jeni të kënaqur me mirëmbajtjen e hapësirave gjelbëruese në QKMF-së, QMF-ve, Zyreve të Gjendjeve Civile, Kopshteve e Fëmijëve, Bibliotekat Fushat Sportive?

Respodent 100


Shumë i/e kënaqur	I/E I kënaqur	E/I Pa kënaqur
74%	16%	10%



4. Sa jeni të kënaqur me shërbimet e NPL" Ambienti" sh.a

Respodent 100


Shumë i/e kënaqur	I/E I kënaqur	E/I Pa kënaqur
76%	18%	6%



5. Sa janë profesional punëtorët e NPL "Ambienti"?

Respondent 100


Shumë i/e kënaqur 74%
I/E I kënaqur 20%
E/I Pa kënaqur 6%



6. Sa jeni të kënaqur me përkuqdesin e kompanies NPL Ambienti SH.A dhe sjelljet e punëtorëve të saj ?

Respondent 100

Shumë i/e kënaqur 74%
I/E I kënaqur 22%
E/I Pa kënaqur 4%




7. Sa jeni të kënaqur me mirëmbajtjen varrezave të Dëshmorëve, lapidareve dhe në Ferizaj?

Respodent 100

Shumë i/e kënaqur

I/E I kënaqur
82%

E/I Pa kënaqur
13%
5%




8. A jeni të kënaqur me përkushtimin dhe rendin e parkingjeve në zonën urbane?

Respodent 100

Shumë i/e kënaqur

I/E I kënaqur
69%


E/I Pa kënaqur
23%
8%



Pyetja e nëntë:

A mendoni se duhet të menaxhohen objektet banesore nga NPL Ambienti Sh.A?

Po 74% Jo 20% Nuk di 6%



Totali

Shumë i kënaqur 75.33% I kënaqur 18.33% I Pa kënaqur 6.33%

REZULTATI I ANKETIMIT PER TE GJITHA PYETJET

Data
25.03.2024

Vendi
Feriza)

Kenat trashë

[Signature]

Në bazë të nenit 33 të Ligjit NR. 03/L-087 për Ndërmarrje Publike, Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" Sh.A Ferizaj, është e obliguar të prokurojë shërbimet e një auditori për kryerjen e auditimit të jashtëm në përputhje me kushtet e përcaktuara në Ligjin për Prokurim Publie, kontrata përkatëse do të ketë kohëzgjatje prej tri (3) viteve. Andaj në bazë të ligjit, ndërmarrja ka lidhur kontratë 3 vjeçare, sipas Ligjit të Prokurimit për kryerjen e auditimit të jashtëm, për pasqyrat vjetore financiare.

NPL Ambienti SH.A.

**Raporti i auditorit të pavarur
dhe pasqyrat financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2023**

Përmbajtja	F
Raporti i Auditorit të Pavarur	-
Deklarata e Pajtueshmërisë	-
Pasqyra e Pozitës Financiare	5
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	7
Pasqyra e Ndryshimit në Ekuitet	8
Pasqyra e Rjedhës së Parasë	9
Shënimet në pasqyrat financiare	10-22

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar menaxhmentit të NPL Ambienti SH.A.

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të NPL Ambienti SH.A.(Kompania), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31.12.2023, pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe shënimet në pasqyrat financiare, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur, në të gjitha aspektet materiale, japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë, pozicionin financiar të Kompanisë 31 dhjetor 2023, dhe rezultatin e saj financiar dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve përshkruhen në mënyrë më të detajuar në paragrafin 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare' në këtë raport. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodi BSNEK) dhe me kërkesat etike që janë relevante për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe Kodit BSNEK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit për Pasqyrat Financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiarë (SNRF), dhe për kontrollet e brendshme, në masën që përcaktohet nga menaxhmenti, është i nevojshëm për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Kompanisë për të vazhduar aktivitetin, duke i shpalosur, kur është e aplikueshme, çështjet në lidhje me vazhdimin e aktivitetit dhe përdorimin e kontabilitetit me parim të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon ta likujdojë Kompaninë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternative tjetër reale përveç se ta bëjë këtë.

Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk është një garancion që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbuloj anomali materiale kur ato ekzistojnë.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimeve ose mashtrimeve dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, pritet që në mënyrë të arsyeshme të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykim profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve apo gabimeve, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe sigurojmë evidencë të auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa rreziku që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontroleve të brendshëm.
- Marrim një kuptim të kontrollit të brendshëm të përshtatshëm për auditim me qëllim të dizajnit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinion mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të Kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një përfundim lidhur me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës së kontabilitetit mbi parimin e vijimësisë nga menaxhmenti, në bazë të evidencave të auditimit të siguruar, nëse ekziston një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshime domethënëse mbi parimin e vijimësisë të Kompanisë. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit për shpalosjet përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse këto shpalosje janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona të auditimit bazohen në evidencat e auditimit të siguruar deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte në të ardhmen mund të ndikojnë që Kompania të ndërpres veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, duke përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura në mënyrë që të arrijnë një paraqitje të drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen e Kompanisë përveç të tjerash, edhe për fushëveprimin e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme të kontrollit të brendshëm që ne kemi identifikuar gjatë auditimit.

Raport mbi kërkesat e tjera ligjore dhe rregullative Opinion mbi Raportin e Menaxhmentit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të NPL Ambienti SH.A. si dhe informacionin e shkruar në raportin e menaxhmentit bazuar në kërkesat ligjore të përcaktuara në Ligjin Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim, neni 10.

Sipas opinionit tonë raporti i menaxhmentit është në përputhje me pasqyrat financiare për vitin financiar raportues si dhe është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim, neni 10, dhe UA Nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit.

Raport mbi kërkesat tjera

- Ne jemi angazhuar si auditor të kompanisë NPL Ambienti SH.A për periudhën 01.01.2023-31.12.2023, më datë 24.04.2024 nga menaxhmenti/aksionarët e kompanisë.

- Ne kemi dizajnuar procedurat e auditimit në mënyrë që t'iu përgjigjemi rreziqeve të identifikuar për të siguruar dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme dhe për të fituar siguri të arsyeshme lidhur me prezantimin e pasqyrave financiare dhe shënimeve shpjeguese.

Ne deklarojmë që nuk kemi ofruar shërbime të ndaluara jo audituese të përmendura në UA nr.02/2019 për pavarësinë e auditorëve ligjor dhe firmave të auditimit, Neni 5 dhe ne jemi të pavarur ndaj subjektit të audituar gjatë kryerjes së auditimit;

ECOVIS UA Kosova Sh.p.k.

Besa Berisha-Auditore Ligjore

Tel.: +383 44 124 898

Adresa: Qendra Tregtare Bregu i Diellit lok.26



Prishtinë, 31.05.2024

Emri i kompanisë: NPL Ambienti SHA

Numri Unik Identifikues: 811053850

Adresa: Dëshmoret e Kombit, Ferizaj

Pasqyra e pozitës financiare

më 31 dhjetor 2023

	Shënimi	Me 31.12.2023	Me 31.12.2022
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	3.3	82,771	50,825
Investimet financiare afatshkurtra		-	-
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3.4	60,942	4,311
Stoqet	3.5	-	-
Pasuritë e tjera afatshkurtra	3.4.1	6,268	5,840
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		149,982	60,976
Pasuritë afatgjata			
Investimet në pjesëmarrje		-	-
Investimet në filiale		-	-
Investimet financiare afatgjata		-	-
Prona, pajisjet dhe impiantet	3.2	12,263	13,754
Prona investuese		-	-
Investimet në vijim		-	-
Pasuritë e paprekshme		-	-
Pasuritë e shtyra tatimore		-	-
Pasuritë e tjera afatgjata		-	-
Gjithsej pasuritë afatgjata		12,263	13,754
Gjithsej pasuritë		162,245	74,730
DETYRIMET DHE EKUITETI			
DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurtra			
Mbitërheqja bankare		-	-
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	3.8	4,258	564
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtër		-	-
Interesi i pagueshëm		-	-
Tatimin në fitim i pagueshëm		8,376	6,484
Provizionet afatshkurta		-	-
Detyrimet ndaj lizingut financiar, pjesa afatshkurtër		-	-
Detyrimet e tjera afatshkurtra	3.7	17,699	13,323
Gjithsej detyrimet afatshkurtra		30,333	20,371
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjatë	3.7	-	-
Provizionet afatgjata		-	-


NPL Ambienti SH.A

Pasqyra e Pozitës Financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2023

(Shumat në Euro)

Detyrimet ndaj lizingut financiar, pjesa afatgjatë		-	-
Detyrimet e shtyra tatimore		-	-
Detyrimet e tjera afatgjata	3.7	-	-
Gjithsej detyrimet afatgjata		-	-
Gjithsej detyrimet		30,333	20,371
EKUITETI			
Kapitali aksionar	3.13	10,000	10,000
Fitimet (Humbjet) e mbajtura	3.13	121,912	44,358
Rezervat e tjera		-	-
Gjithsej ekuiteti		131,912	54,358
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		162,245	74,730

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe nënshkruar në emër të menaxhmentit më 29 mars 2024.



Drejtör Ekzekutiv



Drejtör Financiar

Shënimet shoqëruese prej faqes 13 deri 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e të ardhurave
gjithëpërfshirëse
për vitin që përfundon më 31
dhjetor 2023**

	Shënimi	për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023	për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2022
Të hyrat	3.6	541,447	409,717
Kostoja e shitjes	3.9	-	-
Fitimi / (humbja) bruto		541,447	409,717
Të ardhurat tjera	3.6	12,142	-
Shpenzimet e shpërndarjes	3.10.2	28,391	36,710
Shpenzimet administrative	3.10.1	430,686	365,283
Shpenzimet e tjera		-	-
Fitimi / (humbja) operativ		94,513	7,724
Shpenzimet financiare	3.10.3	375	166
Të ardhurat financiare	3.6		
Fitimi / (humbja) para tatimit		94,138	7,558
Shpenzimet e tatimit në fitim		9,414	756
Fitimi / (humbja) i/e vitit		84,724	6,802
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja, neto nga tatimi			
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja, neto nga tatimi		-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit:		-	-
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit:		84,724	6,802
Shpenzimet nga shpenzimet e pazbritshme		7,171	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit:		7,171	-
Gjithsej të ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit:		77,553	6,802

Shënimet shoqëruese prej faqes 13 deri 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet
për vitin që përfundon më 31
dhjetor 2023**

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Rezervat tjera	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2022	10,000	33,122	4,435	47,557
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	6,802	-	6,802
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet / (Terheqjet) e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2022	10,000	39,924	4,435	54,359
Gjendja më 1 janar 2023	10,000	39,924	4,435	54,359
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	77,553	-	77,553
Diferencat nga përkthimet valutore	-	-	-	-
Dividendat	-	-	-	-
Deponimet / (Terheqjet) e kapitalit shtesë	-	-	-	-
Ndarja e rezervave	-	-	-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	10,000	117,477	- 4,435	131,912

Shënimet shoqëruese prej 13 faqes deri 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave
financiare.

Pasqyra e rrjedhjes së parasë

për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023

	Shënimi	2023	2022
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) para tatimit		84,724	6,802
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.2	1,491	1,864
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Amortizimi i pasurive të paprekshme		-	-
Humbjet nga dëmtimi në pasuritë e paprekshme		-	-
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese		-	-
Të ardhurat financiare	3.6	-	-
Shpenzimet financiare	3.10.1	375	166
(Fitimi) / humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve	3.12	-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim		9,414	756
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		96,004	9,588
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	3.4	-	56,631
(Rritja) / zvogëlimi në stoke	3.5	-	-
(Rritja) / zvogëlimi në pasuritë e tjera	3.4.1	-	429
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	3.8	-	3,694
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet e tjera	3.7	-	4,376
Tatimi në fitim i paguar		-	7,522
Interesi i paguar	3.10.3	-	375
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		39,117	46,410
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.2	-	-
Arkëtimet për shitjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	3.12	-	-
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme		-	-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme		-	-
Interesi i arkëtuar		-	-
Dividendat e arkëtuara		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		-	1,670
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë	3.13	-	-
Shpenzime të papranuara		-	7,171

Arkëtimet nga kreditë dhe huatë	3.7	-	-
Ripagimi i kredive dhe huave	3.7	-	-
Pagesat e lizingut financiar		-	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		- 7,171	-
Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		31,946	44,741
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	3.3	50,825	6,085
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		82,771	50,826

Shënimet shoqëruese prej faqes 13 deri 22 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Entiteti raportues

NPL Ambienti SH.A

Ndërmarrja Publike Lokale "Ambienti" SH.A. është shoqëri aksionare, e regjistruar bazuar në projektin për inkorporimin e sektorit të mirëmbajtjes dhe kujdesit të mjedisit në Kosovë. Kompania është e regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Ndërmarrjeve Biznesore dhe Emrave Tregtar në Kosovë bazuar në ligjin 2007/05-L-123 mbi shoqëritë tregtare dhe posedon nr. unik identifikues 811053850 si dhe qertifikatë regjistrimi për T.V.SH. nr.330331215. Biznesi është i regjistruar si Ndërmarrje Shërbyese dhe aktivitet kryesor ka Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor. Themeluese dhe aksionare e biznesit është Komuna Ferizaj.

Kompania ka fushëveprim të percaktuar në qertifikatën e regjistrimit të biznesit, ndërmarrje shërbyes me aktivitet kryesor të cekur më lartë. Ndërmarrja është regjistruar edhe për kryerjen e aktiviteve sekondare dhe aktivitetëve tjerë.

Pronar/ Aksionarë

Emri Mbiemri

Kapitali në €

Kapitali në %

Komuna Ferizaj

10,000.00 €

100.00 %

Aktivitetet

Kodi Përshkrimi

Tipi

5221 Aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor

Aktiviteti kryesor i biznesit

8121 Pastrimi i përgjithshëm i ndërtesave

Aktiviteti sekondar

8130 Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të shesheve (mjedisit)

Aktivitetet tjera

9321 Aktivitetet e parqeve të argëtimit dhe atyre me orientim të caktuar

Aktivitetet tje

2. Baza e përgatitjes

2.1 Baza e kontabilizimit

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

2.2 Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike.

2.3 Valuta funksionale dhe e prezentimit

Valuta funksionale e Kompanisë e përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare është Euro ashtu siç është valuta e mjedisit ekonomik primar në të cilin punon Kompania dhe pasqyron substancën ekonomike të ngjarjeve të lidhura ("valuta funksionale"). Të gjitha shumat janë në Euro, përveç kur specifikohet ndryshe.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shpalosjet

Politikat kontabël të mëposhtme janë zbatuar në vazhdimësi në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare.

3.1 Toka, Prona dhe pajisjet

Toka, Prona dhe pajisjet janë të mbajtura në pasqyrat e pozicionit me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje nga dëmtimi, nëse ka ndonjë (referojuni tek shënim i Nr. 4). Kosto përfshin shpenzimet që janë drejtpërdrejt të lidhura me blerjen e pasurisë. Zhvlerësimi ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në bazë të jetëgjatësisë së vlerësuar të secilës pasuri duke përdorur metodën lineare.

Pasuritë me qira zhvlerësohen për një periudhë më të shkurtër të afatit të qirasë dhe jetëgjatësisë së tyre tëdobishme. Shpenzimet e mëvonshme kapitalizohen vetëm kur ato rrisin përfitime të ardhshme të pasurisë specifike me të cilat ato lidhen.

Normat e zhvlerësimit të mëposhtme zbatohen për periudhat aktuale dhe krahasuese :

	2023	2022
Ndërtesa dhe infrastruktur	5%	5%
Pajimet dhe Makinerit	10%	10%
Pajimet tjera	20%	20%

Metoda e zhvlerësimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen në çdo datë raportimi.

3.2 Stoqet

Stoqet janë njohur fillimisht sipas koston ose vlerës së realizueshme neto, varësisht se cila është më e ulët. Kostoja përmban koston e blerjes, koston e shendërrimit, dhe të gjitha kostot shoqëruese të ndodhura për të sjellë stoqet në vendin dhe gjendjen aktuale. Vlera e realizueshme neto është çmimi i vlerësuar i shitjes në rrjedhën normale të biznesit, minus kostot e vlerësuara të kompletimit dhe shpenzimet e shitjes.

3.3 Llogaritë e arketueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arketueshme tregtare dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe në vijim me kosto të amortizuar të pakësuara për humbjet për zhvlerësime.

3.4 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paratë në dorë dhe në llogaritë operative në bankë me afat maturimi tre muaj ose më pak.

3.5 Huazimet

Huazimet njihen fillimisht me vlerën e drejtë. Pas njohjes fillestare kreditë dhe huazimet janë paraqitur me koston e amortizuar dhe çdo diferencë mes koston dhe vlerës së ripagesës

njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse përgjatë periudhës së huazimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël dhe shpalosjet (vazhdim)

3.6 Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera

Detyrimet tregtare dhe shumat e tjera të pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallrat dhe shërbimet e pranuar nëse i është faturuar Kompanisë apo jo.

3.7 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën e arkëtuar për mallrat dhe shërbimet e ofruara gjatë rrjedhës normale të biznesit, neto e kthimit të konsumatorëve, zbritjet dhe tatimet e lidhura me shitje.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë të përmbushura:

- Kompania ka transferuar tek blerësit rreziqet e rëndësishme dhe përfitimet e pronësisë së mallrave;
- Kompania nuk e ruan as përfshirjen e vazhdueshme menaxheriale në nivelin që zakonisht lidhet me pronësinë dhe as kontrollin efektiv mbi mallrat e shitura;
- Shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri;
- Është e mundur që përfitimet ekonomike të lidhura me transaksionin të rrjedhin tek entiteti; dhe
- Shpenzimet e bëra ose që do të bëhen në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri.

Te ardhurat nga kontratat e ndertimit njihen në baze të përqindjes së kompletimit të ndertimeve.

3.8 Tatimi në fitim

Tatimi jepet në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin tatimor të Kosovës aktualisht në fuqi, Ligji nr. 03/L-162 "Mbi Tatimin në të Ardhurat e Korporatave"

Shpenzimet e tatimit për periudhën përfshijnë tatimin aktual dhe të shtyrë. Tatimi njihet në fitim ose humbje, përveç pjesës që lidhet me zëra të njohura direkt në kapital ose në të hyra tjera gjithëpërfshirëse.

Tatimi i shtyrë pasuri njihet vetëm në atë masë sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë në dispozicion kundër të cilit mund të përdoren diferencat e përkohshme. Tatimi i shtyrë pasuri rishikohet në çdo datë raportimi dhe zvogëlohet në atë masë që ajo nuk është më e mundur që përfitimet nga tatimi do të realizohen.

Ngarkesa aktuale e tatimit mbi të ardhurat llogaritet në bazë të ligjeve tatimore në fuqi ose në datën e raportimit. Menaxhmenti periodikisht vlerëson qëndrimet e marra në deklaratat tatimore në lidhje me situatat në të cilat rregulloret e zbatueshme tatimore janë subjekt i interpretimit. Ajo përcakton provizione kur është e nevojshme në bazë të shumave që pritet të paguhet në organet tatimore.

3.9 Përfitimet e punonjësve

Kompania nuk ndan asnjë provizion dhe nuk ka obligim për pensionet e punonjësve më të madha se kontributet e paguara në Fondin e Kursimeve Pensionale të Kosovës.

3.10 Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në monedhë të ndryshme nga monedha funksionale (monedha të huaja) regjistrohen me kursin e këmbimit që mbizotëron në datën e kryerjes së transaksioneve. Në çdo datë të bilancit, zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj konvertohen me normat mbizotëruese në datën e bilancit të gjendjes. Zërat jo monetarë që maten në termat e kostos historike në monedhë të huaj nuk konvertohen. Diferencat e këmbimit që rrjedhin nga zërat monetarë, janë të përfshira në fitimin dhe humbjen e periudhës në të cilën lindin.

3. Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

3.11 Rënia në vlerë

Vlera kontabël e pasurive të kompanisë, me përjashtim të stokeve rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për rënie në vlerë. Nëse ka tregues të tillë, shuma e rikuperueshme e pasurisë vlerësohet.

Një humbje nga rënia në vlerë njihet kur vlera kontabël e një pasurie ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon shumën e rikuperueshme. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën e fitimit ose humbjes. Për një pasuri që nuk gjeneron rrjedha hyrëse të parasë të pavarura, shuma e rikuperueshme përcaktohet për njësinë gjeneruese të mjeteve monetare të cilës i përkasin pasuritë.

Në lidhje me pronat, impiantet dhe pajisjet, një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme.

3.12 Të hyrat dhe shpenzimet financiare

Të hyrat financiare përfshijnë të hyrat e interesit në bilancat e bankave të njohura në fitim ose humbje. Të hyrat nga interesi njihen si akruale, duke përdorur metodën efektive të interesit. Shpenzimet e interesit njihet në pasqyrën e fitimit ose humbjes në bazë akruale duke përdorur metodën efektive të interesit.

3.13 Kontigjencat dhe provizionet

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveq nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Pasuria kontingjente nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

Provizioni njihet nëse kompania ka një detyrim aktual (ligjor ose konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, është e mundur që një dalje e burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike do të kërkohej për të shlyer detyrimin; dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet për shumën e obligimit.

3.14 Parimi i vazhdimësisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimin e vazhdimësisë, e cila supozon realizimin e pasurive dhe shlyerjen e detyrimeve në rrjedhën normale të biznesit.

3.15 Gjykimet kritike dhe burimet kyçe të pasigurisë së vlerësuar

Në procesin e zbatimit të politikave të kontabilitetit të Kompanisë, të cilat janë të përshkruara më sipër, menaxhmenti nuk ka bërë asnjë gjykim që ka ndikim të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare.

Supozimet kyçe lidhur me të ardhmen, dhe burime të tjera kyçe të vlerësimit të pasigurisë në datën e raportimit, që rrezikojnë të shkaktojnë një rregullim material në vlerën kontabël të pasurive dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar, janë diskutuar më poshtë:

Detyrimi aktual tatimor

Pasqyrat financiare të Kompanisë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023 i nënshtrohen inspektimit nga autoritetet tatimore vendore, ku menaxhmenti i Kompanisë ka përdorur vlerësimin dhe gjykimin e tij më të mirë, për të qenë në përputhje me ligjet tatimore. Për shkak të përdorimit të gjykit për të përmbushur kërkesat e caktuara të ligjeve tatimore dhe në varësi të vlerësimit të autoriteteve tatimore, detyrimi tatimor më 31 dhjetor 2023 mund të ndryshojë në krahasim me atë të raportuar në këto pasqyra financiare.

Provizioni për dëmtim të llogarive të arkëtueshme dhe rënien në vlerë të stoqeve

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësim për rikuperimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme dhe stoqeve. Bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e llogarive të arkëtueshme dhe rënien në vlerë të stoqeve. Faktorët dhe rrethanat e shqyrtuara nga menaxhmenti me datën e raportimit nuk rezultojnë në provizionim të llogarive të arkëtueshme dhe stoqeve.

3.16 Adoptimi i Standardeve të reja dhe të rishikuara Ndërkombëtare të Raportimit Financiar

a. Standardet dhe interpretimet në fuqi në periudhën raportuese

Standardet e mëposhtme, ndryshimet në standardet ekzistuese dhe interpretimet të leshuara nga Bordi Standardeve Nderkombetare të Kontabilitetit janë efektive për periudhën e raportuese:

SNRF 14 - Llogaritë e shtyra rregullatore

Ndryshimet në SNRF 11 - Kontabiliteti për blerjen e interesit në operacionet e përbashkëta

Ndryshimet në SNK 16 dhe SNK 38 - Sqarimi i metodave të pranueshme të zhvlerësimit dhe amortizimit

Ndryshimet në SNK 27- Metoda e kapitalit në pasqyrat financiare individuale

Ndryshimet në SNRF 10, 12 dhe SNK 28- Entitetet investuese, aplikimi i perjashtimeve

Ndryshimet në SNK 1- Iniciativa e shpalosjeve

Miratimi i këtyre ndryshimeve në standardet dhe interpretimet ekzistuese nuk ka dërguar në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Kompanisë apo pozitës dhe performancës financiare.

SNRF 9 Instrumentet financiare

Në korrik 2014, Bordi për Standardet Ndërkombetare të Kontabilitetit lëshoi version final të SNRF 9 Instrumentet Financiare. SNRF 9 është efektiv për periudhat që fillojnë më apo pas 1 janarit 2018.

SNRF 15 Te hyrat

SNRF 15 krijon një kuadër të plotë për të përcaktuar nëse, sa dhe kur të ardhurat do të njihet. Ajo zëvendëson SNK 18 Të ardhurat, SNK 11 kontratat e ndërtimit dhe KIRFN 13 Programet e Besnikërisë së Klientit.

SNRF 15 është në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2018 dhe miratimi e hershem lejohet. Standard i ri ofron një kornizë që zëvendëson njohjen e të ardhurave udhëzimet ekzistuese në SNRF. Subjektet do të miratojnë një model pesë-hapësh për të përcaktuar se kur do të njohin të ardhurat, dhe në çfarë shume. Modeli i ri përcakton se të ardhurat duhet të njihen kur (ose si) një entiteti transferon kontrollin e mallrave apo shërbimeve për një klient në shumën për të cilën entiteti pret të ketë të drejtë. Edhe pse entiteti ende nuk ka përfunduar plotësisht vlerësimin fillestar të ndikimit të mundshëm të SNRF 15 në pasqyrat financiare të saj, drejtimi nuk pret që standardi i ri, kur aplikohet fillimisht, do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të entitetit. Koha dhe malja e të ardhurave të entitetit nuk pritet të ndryshojë në bazë të SNRF 15 për shkak të natyrës së operacioneve të entitetit dhe llojet e të ardhurave që fiton.

IFRS (SNRF) 16 Qiratë

IFRS (SNRF) 16 paraqet një model të vetëm të qerazë në pasqyrë e pozicionit financiar për qiratë. Qiramarrësi e njëj të drejtën e përdorimit të asetit bazë dhe përfaqëson të drejtën e tij për ta përdorur asetin dhe të njëj detyrim për qira, që përfaqëson obligimin për t'i bërë pagesat e qirasë. Ka përjashtime opsionale për qiratë afatshkurtëra dhe për qiratë e sendeve me vlerë të vogël. Kontabiliteti (regjistrimi) për qiradhënësin mbetet i njëjtë me standardin aktual, dmth qiradhënësi do të vazhdojë ta klasifikojë qiranë si qira financiare ose qira operative (të zakonshme).

IFRS (SNRF) 16 zëvendëson udhëzimet (standardet) ekzistuese për qiratë duke përfshirë SNK 17 Qiratë, IFRIC (KIRFN) 4 Përcaktimi nëse një marrëveshje përmban qira, SIC (KIS) 15 Qiratë operative (e zakonshme) – Stimujt, SIC (KIS) 27 Vlerësimi i përmbajtjes së transaksioneve që përfshijnë formën ligjore të një qiraje.

Ky standard është efektiv (hyn në fuqi) për periudhat që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019. Aplikimi (zbatimi) i mëhershëm është i lejuar për entitetet që zbatojnë IFRS (SNRF) 15 Të ardhurat nga kontratat me klientët, më ose para datës fillestare të aplikimit të IFRS (SNRF) 16

Entiteti nuk pret që standardi i ri, kur aplikohet fillimisht, do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare për shkak se njësia ekonomike nuk është palë në një marrëveshje kontraktuale që hyn në fushën e SNRF 16

Iniciativat e shpalosjes (Shtesat për SNK 7)

20. Zotimet dhe kontingjentet

(i) Zotimet

Kompania nuk ka hyrë në zotime kontingjenca për vitin më 31 dhjetor 2023 dhe 31 dhjetor 2022.

21. Instrumentet financiare –Vlera e drejt dhe menaxhimi i riskut

Vlera e drejtë

Kompania ka pasuri financiare të cilat përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme, paraja dhe ekuivalentët e saj. Kompania ka detyrime financiare të cilat përbëhen nga akrualet, kredite dhe të pagueshmet e tjera. Vlerat e drejta të këtyre instrumenteve financiare nuk janë materialisht të ndryshme nga vlera e tyre e deklaruar për shkak të maturitetit të tyre të shkurtër ose kushteve të tjera.

Menaxhimi i rrezikut

Kompania ka ekspozim ndaj këtyre risqeve të cilat lindin nga instrumentet financiare në posedim:

- (i) *Rreziku kreditor*
- (ii) *Rreziku i likuiditetit*
- (iii) *Rreziku i tregut*

(i) Rreziku kreditor

Instrumentet financiare të cilat potencialisht e ekspozojnë kompaninë ndaj përqendrimeve të rrezikut kreditor përbëhen kryesisht nga balancat e të arkëtueshmeve dhe të parave të gatshme. Ekspozimi i Kompanisë ndaj rrezikut kreditor ndikohet kryesisht nga karakteristikat individuale të secilit klient. Kompania ka krijuar një politikë kreditore nën të cilën secili klient i ri analizohet individualisht për besueshmëri para se termat dhe kushtet e pagesës dhe të dërgesës të ofrohen. Rreziku kreditor i të arkëtueshmeve kontrollohet me anë të aprovimeve të arkëtueshmeve dhe shpenzimeve buxhetore që i gjenerojnë të arkëtueshmet e tilla. Rreziku kreditor në paratë e gatshme kontrollohet duke investuar në bankat me reputacion në Kosovë.

Paqëndrueshmëria në tregjet financiare botërore dhe ato të Kosovës

Kriza e vazhdueshme botërore financiare dhe kriza ekonomike ka rezultuar në, ndër të tjera, një nivel më të ulët të financimit të tregut të kapitaleve, nivele më të ulëta të likuiditetit në sektorin bankar, dhe, kohë pas kohe, norma më të larta ndërbankare interesi dhe paqëndrueshmëri më të lartë në tregjet e aksioneve. Pasiguritë në tregjet globale financiare kanë rezultuar edhe në dështime të bankave dhe shpëtime të bankave në të gjithë botën. Shtrirja e plotë e ndikimit të krizës financiare së vazhdueshme po dëshmon të jetë e pamundur për t'u parashikuar ose për tu mbrojtur plotësisht nga ajo.

Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit rrjedh nga financimi i përgjithshëm i aktiviteteve të kompanisë dhe menaxhimi i pozicioneve. Përfshinë edhe rrezikun e të mos qenit në gjendje për të financuar pasurinë me maturitet dhe norma të përshtatshme dhe rrezikun e të mos qenit në gjendje për të likuiduar një pasuri me një çmim të arsyeshëm dhe afat kohor të përshtatshëm për të përmbushur detyrimet. Kompania e monitoron likuiditetin e saj në baza mujore me qëllim që të menaxhojë obligimet e saj kur ato vijnë për tu përmbushur.

(ii) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut është rreziku që ndryshimi i çmimeve të tregut si kursi i këmbimit të valutave, norma e interesit apo çmimi i aksioneve do të ndikojë në të hyrat dhe instrumentet financiare të mbajtura nga kompania. Ojektivat e menaxhimit të rrezikut është që të menaxhojë dhe kontrollojë ekspozimin ndaj rrezikut të tregut brenda parametrave të pranueshëm, dhe duke optimizuar kthimet.

Rreziku i valutave të huaja

Kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të valutave të huaja pasi që shumica e fondeve pranohen dhe shpenzohen në Euro. Kompania nuk përdor instrumente derivative për të shmangur ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kursit të këmbimit të huaj.

Rreziku i normës së interesit

Të ardhurat e kompanisë dhe flukset e mjeteve monetare operative janë në thelb të pavarura nga ndryshimet në normat e interesit të tregut. Instrumentet financiare të kompanisë që bartin interes janë kredite (nota 9). Instrumentet në posedim të kompanisë janë me norma fikse të interesit andaj kompania nuk është e ekspozuar ndaj rrezikut të normës së interesit.

3.3 Paraja dhe ekuivalentët e parësë

Pershkrimi	Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
	€	€
Paraja në arkë	6,990	3,941
Paraja në bankë	75,781	46,885
Depozitat afatshkurta bankare		
Gjithsej Paraja dhe Ekuivalentet e saj	82,771	50,825

Për qëllime të pasqyrës së rrjedhjes së parësë së gatshme :

Pershkrimi	Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
	€	€
Paraja dhe ekuivalentët e parësë	82,771	50,825
Mbitërheqja bankare		
	82,771	50,825

3.4 Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Pershkrimi	Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
	€	€
Të arkëtueshmet tregtare – neto	60,942	4,310
Të arkëtueshmet tjera		
Gjithsej llogaritë e arkëtueshme	60,942	4,310

3.4.1 Parapagimet

Pershkrimi	Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
	€	€
Parapagimi për Tatim në Fitim		
Parapagimet tjera	6,268	5,840
Gjithsej parapagimet	6,268	5,840

3.13 Kapitali dhe Rezervat

Pershkrimi	Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
	€	€
Kapitali themelues	10,000	10,000
Fitimet/(Humbjet) e bartura ne filim te vitit	44,358	37,556
Fitimi/(Humbja) e vitit	77,553	6,802
Dividendat/Terheqjet		
Rezervat e Rivleresimit/Tjera		
Gjithsej ekuiteti	131,911	54,358

Detyrimet e tjera afatshkurtra

Pershkrimi	Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
Obligimi për Tvsh	7,020	5,971
Tatimi ne paga I pagueshëm	3,045	2,104
Kontributi i pagueshëm	5,401	4,225
Detyrime tjera afatshkurtëra	2,233	460
Gjithsej Detyrimet Afatshkurtëra	17,699	12,760

3.8 Llogaritë e Pagueshme/Furnitorët

Pershkrimi	Me 31 Dhjetor 2023	Me 31 Dhjetor 2022
	€	€
Furnitorët		
Të pagueshmet ndaj furnitorëve	4,258	564
Të pagueshmet tjera		
Gjithsej llogaritë e pagueshme	4,258	564

3.6 Të hyrat

Pershkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2022
	€	€
Të hyrat nga Komuna	153,336	95,045
Të hyrat nga shitja e tiketave	312,625	253,147
Të hyrat nga tregjet komunale	51,688	49,245
Të hyrat nga parkingjet e rezervuara	23,797	12,280
Të hyrat tjera	12,142	
Gjithsej te hyrat	553,589	409,717

3.10.1.1 Kosto e personelit

Përshkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2022
	€	€
Pagat neto	362,596	310,789
Tatimi ne paga	16,707	12,952
Kontributi i puntorit	19,963	17,039
Pagat Bruto	399,266	340,780
Kontributi i pundhenesit	19,963	17,039

3.10.1 Shpenzimet Administrative

Përshkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2022
	€	€
Shpenzimet e Energjis Elektrike		
Shpenzimet e Zyres	3,505	1,237
Shpenzimet e perfaqsimi	4,358	1,283
Shpenzimet per sigurim tenderi		
Shpenzimet e Telefonit dhe Internetit	818	871
Shpenzimet e Donacioneve		
Shpenzimet Komunale		
Shpenzimet Pagave *3.10.1.1	419,230	357,819
Shpenzimet tjera administrative	2,776	4,073
Gjithsej Shpenzimet Administrative	430,686	365,283

3.10.2 Shpenzimet e Shpërndarjes

Përshkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2022
	€	€
Shpenzimet e Reklamës		
Shpenzimet e Karburanteve	4,081	3,299
Shpenzimet e Shtjjes		
Shpenzimet e Sigurimit / Regjistrimit	1,297	1,109
Shpenzimet e hapsirave te gjelbra	4,526	15,675
Shpenzimet e Zhvlersimit	1,491	1,864
Shpenzimet tjera të shpërndarjes	16,996	14,763
Gjithsej shpenzimet e shperndarjes	28,391	36,710

3.10.3 Shpenzimet financiare

Përshkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2022
	€	€
Shpenzimet e interesit nga kreditë	375	166
Shpenzimet e interesit nga mbitërheqjet		
Shpenzimet e interesit nga lizingu financiar		
Gjithsej	375	166

Këste të Paguara gjate vitit

Përshkrimi	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2023	Viti i mbyllur me 31 Dhjetor 2022
	€	€
TM1	259	4,705
TM2	259	4,705
TM3	259	500
TM4	259	
Gjithsej	1,038	9,910

MIRATIMI I RAPORTIT VJETOR 2023

Miratimi i raportit vjetor nga Bordi i Drejtorëve i Ndërmarrjes Publike Lokale "Ambienti" Sh.A Ferizaj, është bërë në mledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me 31.05.2024.

Kryesues i Bordit të Drejtorëve
të NPL "Ambienti"


Gent Ratkoceri



Kryeshef Ekzekutiv
i NPL "Ambienti"


Arton Gavazi